



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIATEPELENË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 228/8 prot.

Tepelenë, më 03.02.2025

**V E N D I M**

Nr. 10, datë, 30.01.2025

**“PËR MIRATIMIN PLANIT OPERACIONAL PËR VITIN 2025 NË FONDIN PYJOR DHE  
KULLOSOR TË BASHKISË TEPELENË“**

Në mbështetje të, pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, të pikave 5 dhe 6 të nenit 27 dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr.8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjit nr.57/2020 "Për pyjet".VKM 438 datë 08.06.2016 "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit pyjor dhe të prodhimeve të tjera pyjore dhe jopyjore" si dhe në mbështetje të V.K.M 559 datë 29.07.2022 " Për përcaktimin e tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe prodhimet drusore jo pyjore" Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave/bashkive".

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë, propozimin e Drejtorisë së Zhvillimit Rural për përgatitjen e Planit operacional vjetor për vitin 2025.
2. Të ngarkohet Kryetari i Bashkisë Tepelenë dhe Sektori i Shërbimit pyjor pranë Drejtorisë së Zhvillimit Rural, si dhe Njësitë Administrative për ndjekjen e zbatimit e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miratuar me 12 (trembëdhjetë) vota  
Vota Pro 12 (trembëdhjetë)vota  
Vota Kundër -  
Vota Abstenim 1 (një) votë  
Zbardhur më datë 03.02.2025

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**ARBEN GUMENI**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TEPELENE**

**PLAN OPERACIONAL**

**PËR PYJET DHE KULLOTAT NË PRONËSI TË BASHKISË TEPELENE**

**VITI 2025**

**PËRGATITI  
Avni Abedini**

**KONTROLLOI  
Gëzim Shehu**

**KRYETARI I BASHKISË  
Tërmet Peci**

Ky plan u miratua në këshillin e bashkisë më datë 30/10/2025



# PLANI OPERACIONAL PËR ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN E QËNDRUSHËM TË PYJEVE DHE KULLOTAVE NË KOMUNËN PETRAN

## Hy rje

Ky plan operacional, bëhet në kuadrin e ligjit 57/2020 "Per Pyjet", ligjit 9693 date 19.03.2007 "Per fondin kullisor", i ndryshuar, transferimi i të pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkise Tepelenë VKM nr. 433 date 08.06.2016 "Per transferimin ne pronesi te Bashkise te Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listes se inventarit dhe aktualisht të administrimit të Ministrisë se Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive", i ndryshuar, VKM 104 dt.05.02.2020, VKM 559, date 22.07.2022 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e cmimeve dhe tarifave për dhenien ne perdorim/shfrytezim te fondit pyjor kombetar,per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore".

Plani operacional i ndërhyrjeve në terrenet pyjorë/kullisorë është një dokument teknik me vlerë praktike i cili hartohet dhe përditësohet çdo vit nga zyra e pyjeve dhe kullotave në bashki. Në kuptimin e ngushtë të tij, plani operacional është instrumenti që vë në zbatim (implementon) planin e menaxhimit. Në këtë kontekst plani operacional nuk mund të jetë aspak një kopje shabllone që duhet të imitojë pikë për pikë planin e menaxhimit. Duke qënë se ai piketohet dhe formulohet nga specialistët e NjQV-së me pjesmarrjen e përfaqësuesve të komunitetit, bazuar në nevojat dhe mundësitë reale të periudhës kohore në të cilën është duke kaluar komuniteti dhe pushteti lokal, ky dokument merr një funksion dinamik i cili e bën atë një mekanizëm mjaft efikas për realizimin e ndërhyrjeve me punime dhe masa të tjera menaxhuese të cilat sigurojnë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik-mjedisor të këtyre burimeve natyrore me vlerë të përjetëshme. Nga ana tjetër plani operacional parashikon mundësinë dhe mekanizmat për vjeljen e të ardhurave nga fondi pyjor/kullisor që disponon NjQV-ja. Kjo e ardhur financiare përbën shtratin e sigurt e të përhershëm për ri-investime periodike në këto burime natyrore me qëllim rritjen e kapaciteteve prodhuese të tyre dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë bio-ekologjike.

Gjartë hartimit të planit operacional janë mbajtur parasysht:

**VIZIONI:** Për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të familjeve që shfrytëzojnë kullotat dhe pyjet i cili realizohet nëpërmjet planifikimit dhe zbatimit të menaxhimit të qëndrueshëm të terreneve pyjorë/kullisorë të marrë në përdorim ose pronësi prej tyre dhe mbështetet me ndërhyrje përmirësuese për rritjen e kapaciteteve prodhues dhe me ndërtime infrastrukturore nga bashkia, qeveria dhe donatorë të tjerë të jashtëm e të brëndshëm.

**QELLIMI:** Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm i komuniteteve në zonat malore të vëndit dhe ruajtja e ekosistemeve natyrore në mjediset për rreth.

#### **OBJEKTIVAT:**

- 1.Frenimi i degradimit të mbulesave bimore dhe fillimi i ripërtëritjeve të tyre sipas cikleve natyrore;
- 2.Frenimi i shplarjes dhe gërryerjes sipërfaqësore të terreneve toksorë nga reshjet atmosferike;
- 3.Fillimi i zbatimit të kullotjes ekstensive të kontrolluar;
- 4.Mbrojtja e biodiversitetit të llojeve dhe në veçanti e atyre me rrezik zhdukje;
- 5.Forcimi i procesit të vjeljes së tarifave sezonale nga burimet pyjore/kullosore dhe krijimi i fondit të ri-investimeve në pyje/kullota;
- 6.Ristrukturimi i peizazheve dhe fillimi i aktiviteteit të eko-turizmit malor, edukativ dhe fetar.

#### **KOHËZGJATJA.**

Një plan operacional ka afat veprues për një vit. Për çdo vit pasardhës ai i nënshtrohet përditësimit me problemet e dala gjatë rrjedhës së procesit kompleks të menaxhimit të qëndrueshëm të terreneve pyjorë/kullosorë që administrohen nga NjQV-ja ose pronarët privatë.

**ARSYEJA.** Hartimi i planit operacional është një nevojë praktike për ta bërë procesin e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, dinamik të përshtatshëm me ndryshimet e paparashikuara në kohë dhe hapsirë që konsatohen në rrjedhën e kohës.

Në hartimin e planit operacional jemi bazuar së pari në gjëndjen aktuale të pyjeve dhe kullotave të komunës të bashkisë.

### **1. ANALIZA E PËRGJITHËSHME SOCIAL-EKONOMIKE KOMUNA PETRAN**

#### **I.1 TË DHËNA DEMOGRAFIKE:**

Bashkia e Tepelenës ka një sipërfaqe të territorit të saj prej 431.25 km<sup>2</sup> dhe me nje popullsi afersisht 15000 banor. Qendra e bashkisë është qyteti I Tepelenës. Territori I bashkisë Telenë shtrihet në Qarkun Gjirokastrë, në të dy anët e Lumit Vjosë.

Bashkia Tepelene perbehet nga Njesi Administrative: Qëndër, Gusmar dhe Lopës te cilat permbledhin fshatrat Brenda territorit te tyre, si dhe Qyteti Tepelene.

#### **I.2 AKTIVITETET KRYESORË**

Dy janë aktivitetet kryesore ekonomike të banorëve në fshatrat e bashkisë Tepelenë: (i) mbarështimi i blegtorisë. krvesisht të të imtave: (ii) Buiqesia dhe vreshtaria: (iii) grumbullimi dhe tregëtimi i

bimëve mjeksore-aromatike që rriten në territorin e komunës. Në drejtim të shfrytëzimit të terreneve pyjorë, familjet rezidente ushtrojnë tradicionalisht prodhimin e druve të zjarrit vetëm për efekt ngrohje dhe gatim familjar.

### **I.3 BURIMET KRYESORË TË TË ARDHURAVE**

Burimi kryesor i të ardhurave ekonomike për familjet e fshatrave të bashkisë Tepelene është blegtoria dhe vreshtaria. Familjet rezidente të komunës e kanë trashëgimi shumë të lashtë profesionin e mbarështuesit të tufave me të imta. Ky fenomen bazohet në burimet natyrore kullosore që shtrihen në pjesën më të madhe të territorit të komunës. Bujqësia përbën aktivitetin e dytë të rëndësishëm të banorëve të komunës. Ndonëse sipërfaqet e tokave bujqësore janë të kufizuara, familjet i përdorin ato për ti kultivuar kryesisht me llojet foragjere shumë vjeçare (jonxhat, tërfilët etj.) por edhe me hasëlle njëvjeçarë të cilët i përdorin si ushqime të konservuar ose të freskët për tufat e tyre.

Në territorin e Bashkisë rriten lloje me vlera mjeksore, eterovajore e tanifere të cilat kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë vlerë tregu. Banorët i kanë shfrytëzuar këta burime natyrore për interesat e tyre ekonomike. Çdo vit nga familjet rezidente në bashki vilen dhe tregëtohen periodikisht: gjethe sherebele, herba rigoni, lule murrizi, lulebasani, kokërr trëndafili i egër, çaj mali, gjethe trumëze etj., të ardhurat që sigurohen nga ky aktivitet zënë vëndi të rëndësishëm të plotësimit të nevojave monetare për çdo familje.

Në stadin e transformimeve të mëdha që po ndodhin në gjithë vëndin tonë për të drejtat e përdorimit e të pronësisë për pyjet dhe kullotat, deri më sot Bashkia ka arritur të regjistrojë në zyrën e regjistrimit të pasurive të patundëshme disa pasuri pyjore/kullosore. Terrenet pyjorë/kullosorë të bashkisë përdoren periodikisht nga familjet rezidente si dhe me rritjen e atraksionit turistik dhe agroturizmit shfaqin interes edhe banor jo rezident të bashkisë bazuar në aktmarrëveshjet që lidhen periodikisht sipas ligjit dhe rregulloreve në fuqi. Terrenet pyjorë përdoren sipas mënyrave dhe formave tradicionale.

### **I.4 Vlerësimi i potencialeve prodhues të burimeve natyrore në pyje/kullota**

Në bashkinë Tepelenë pyjet zënë një sipërfaqe prej \_\_\_\_\_ ha. Ata përdoren kryesisht për furnizimin e komunitetit me dru zjarri, për kullotje dhe për sigurimin e bazës ushqimore të thatë për blegtorinë.

Bashkia ka një sipërfaqe pyjore e kullosore e ndarë si më poshtë :

1. Pyje	9354 ha.
2. Kullote	20050 ha
3. Tokë bujqësore	3297ha

### **I.5 BILANCI I NEVOJAVE PËR MATERIAL DRUSOR**

Drutë e zjarrit prodhohen kryesisht nga llojet shkozë, bungë, bulgër, prrall rrap etj. Pothuajse i gjithë transporti i druve të zjarrit bëhet me kafshë dhe shumë pak me automjete . I vetmi burim energjie që shërben për të plotësuar nevojat për ngrohje dhe gatim familjar janë drutë e zjarrit.

**Nevojat periodike për dru zjarri nga familjet rezidente të bashkisë (m<sup>3</sup>).**

Nr	Fshati	Nr. i familjeve	Nevojat për dru ne m <sup>3</sup> zjarri		Grumbulluar nga :			Burime të tjerë.		
			Për familje	Total	Pyjet e bashkisë	Pyet e Zonave të mbrojtura	Nga krasitja e drureve frutorë dhe tregu I lirë	Qymyr	Elektrik	Gaz
								(kv)	(Kë/h)	(litra)
1	Dragot		5	150	115	0	35		Po	Po
2	Becisht		5	75	50	0	25		Po	Po
3	Peshtan		5	60	0	45	15		Po	Po
4	Mezhgoran		5	75	0	60	15		Po	Po
5	Koder		5	100	70	0	30		Po	Po
6	Lekel		5	75	50	0	25		Po	Po
7	Hormove		5	350	310	0	40		Po	Po
8	Luzat		5	150	110	0	40		Po	Po
9	Bence		5	120	105	0	15		Po	Po
10	Veliqot		5	350	310	0	40		Po	Po
11	Dukaj		5	200	150	0	50		Po	Po
12	Turan		5	60	40	0	20		Po	Po
13	Mamaj		5	75	45	0	30		Po	Po
14	Salari		5	100	80	0	20		Po	Po
15	Lab Martaloz		5	40	25	0	15		Po	Po
16	Dhemblan		5	170	145	0	25		Po	Po
17	Sinanaj		5	130	110	0	20		Po	Po
18	Matohasana j		5	60	45	0	15		Po	Po
19	Dorez		5	10	0	0	10		Po	Po
20	Lekdush		5	90	75	0	15		Po	Po
21	Progonat		5	350	315	0	35		Po	Po
22	Gusmar		5	120	105	0	15		Po	Po
23	Rexhin		5	60	45	0	15		Po	Po
24	Nivice		5	120	105	0	15		Po	Po
25	Qyteti Tepelene		5	700	600	0	100		Po	Po
				<b>3790</b>	<b>3005</b>	<b>105</b>	<b>680</b>			

Shënim, në këtë tabelë nuk është llogaritur sasia e druve të zjrrit për ngrohje për shkollat, pasi nevojat për shkollat llogaritet në fillim të sezonit shkollor (shtator-tetor).

Duke parë tabelën e mësipërme mund të themi se 82 % e druve të zjrrit që konsumohen nga familjet rezidente të bashkisë merren periodikisht nga pyjet e bashkisë.

Furnizimi me dru zjarri për një pjesë të nevojave të komunitetit për gjatë vitit 2022 u sigurua nga nderhyrjet me prerje shëndetësimi në ngastrat e dala ne ankand, sipas procedurave ligjore. Edhe gjatë vitit 2024 është planifikuar të vazhdojë ky proces për të furnizuar komunitetin me dru zjarri për dy arsye kryesore: a) për plotësimin e nevojave të tyre për ngrohje e gatim familjar si dhe: b) për përmirësimin e terreneve pyjorë.

Gjithashtu lind nevoja e energjences për hartimin e planeve të menaxhimit.

## **I.6 GJËNDJA E KAPACITETEVE KRERËMBAJTËS TË KULLOTAVE**

Kullotat që ndodhen në pronësinë e bashkisë kapin një sipërfaqe prej 20050 ha ndërsa pjesa tjetër në pronësi të shtetit dhe të pronarëve privatë.

Fondi kullor shtrihet në një lartësi prej 220 - 2222 m mbi nivelin e detit dhe ai përbëhet kryesisht nga kullota verore prej të cilave sigurohet pjesa më e madhe e bazës ushqimore të blegtorisë si nëpërmjet kullotjes së lirë ekstensive ashtu edhe në grumbullimin e rezervave ushqimore foragjere për periudhen dimërore nëpërmejt livadheve të kositjes.

Gjëndja e kullotave në këtë bashki në disa ngastrat paraqitet e dobët dhe në disa të tjera mesatarisht e dobët si në sasi ashtu edhe në shumëllojshmëri, sidomos në ato ngastrat që janë në afërsi të fshatrave të cilat pothuajse janë vazhdimisht të mbingarkuara me kafshë gjatë gjithë sezonit kullor. Kjo gjëndje e kullotave ka ardhur si rezultat i mbikullotjes si dhe i masave të pa mjaftushme për ti mirëmbajtur dhe për ti përmirësuar ato. Gjithashtu lind nevoja e energjences për hartimin e planeve të menaxhimit.

Për vitin 2025, brenda muajit shkurt, do përgatitet nga sektori i pyjeve në Drejtorinë e Zhvillimit Rural në Bashki, lista e ngastrave kullorë e pyjorë që do të jepen me qëra sezonale për kullotje me bagëti në cdo Njësi Administrative (Gusmar, Qëndër, Sinanaj), sipas udhëzimit dhe ligjit në fuqi për kullota e livadhet.

Gjithashtu, Njësitë Administrative do të dërgojnë evidencë mujore për të ardhurat nga kullotat e pyjet cdo muaj në Sektorin e Pyjeve në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, me kopje të dokumentacionin përkatës.

Në bashkinë Tepelenë, përveç të ardhurave të drejtpërdrejta nga pyjet dhe kullotat, komuniteti siguron të ardhura edhe nëpërmjet grumbullimit të bimëve mjeksore-aromatike si: sherebela, rigoni, murrizi, lule bliri, trëndafili i egër, trumëza etj. Këto bimë mblidhen në mënyrë të pa-organizuar nga komuniteti dhe nërdoren për tu tregëtuar dhe për përdorim të kufizuar familjar.

## **II. VLERËSIMI I TREGJEVE**

### **II.1 Drutë e zjarrit.**

Kërkesat e banorëve të Bashkisë Tepelenë për dru zjarri plotësohen përgjithësisht nga pyjet e bashkisë. Sipas vlerësimeve të bëra në vitin e fundit rezulton se sasia e druve të zjarrit që tërhiqet nga fondi i pyjeve të bashkisë zë 82 % të nevojave mezzatave të familjeve rezidente ndërkohë që nga perdorimi i materialeve nga krasitja e druveve frutorë/pemtarisë si dhe tregu i lirë plotësohen mesatarisht 18 % e nevojave vjetore për dru zjarri. Në përgjithësi tregu i sotëm i lëndëve djegëse që shërbejnë për ngrohje dhe gatim familjar mbizotërohet nga drutë e zjarrit. Kërkesa për dru zjarri kanë jo vetëm familjet që banojnë në fshat por edhe familjet me banim në qytet. Prodhimi i druve të zjarrit nëpërmjet përmirësimeve të sipërfaqeve pyjorë me prerje shendetësimi/ rrallime është një aktivitet ekonomik ndihmës për komunitetin. Çmimi i shitjes së druve të zjarrit sipas çmimeve për tre vitet e fundit është luhatur ndërmjet 3000 Lekë/m<sup>3</sup> deri në 5000 Lekë/m<sup>3</sup> (kjo në vartësi të llojit, largësisë të parcelave ,cilesise etj).

### **II.2 Bimët mjeksore**

Tregu i sotëm ka mjaft kërkesa për bimë mjeksore të llojeve të ndryshëm por grumbullimi i tyre në territorin e Bashkisë Tepelenë bëhet i pa organizuar dhe duke mos respektuar rregullat teknike. Nga ana tjetër mungojnë aktmarrëveshjet ndërmjet shitësve dhe blerësve. Jo vetëm në rrethin e Tepelenës por edhe në rang qarku ka disa pika grumbullimi për BMET (Bimët mjeksore, eterovajore e tanifere).

### **II.3 Prodhimet frutore dhe prodhimet e dyta në pyjet/kullota të bashkisë**

Këto prodhime përbëhen nga kokrrat e arrës, kokrrat e lajthisë, kokrrat e gështenjës, kokrrat e mollës së egër, frutat e goricës, frutat e luleshtrydhes etj., të cilat janë një burim të ardhurash ushqimore dhe monetare për komunitetin e bashkisë. Në periudhën e sotme tregjet kanë nevojë për kokrra lajthie, kokrra gështenje, manaferra. Këto janë fruta që përdoren gjërësisht në industrinë ushqimore të prodhimit të ëmbëlsirave etj., por kërkohen gjithashtu për konsum familjar edhe nga tregjet e lirë në qytetet tanë. Çmimet e shtijes së frutave pyjore ndryshojnë sipas llojeve dhe stinëve kur ato vilen dhe tregëtohen. Le të citojmë më poshtë çmimet për 1 kg prodhim në sezonin e fundit '2024.

1) arra.....500 l; 2) lajthia.....700 l;

## **III. ANALIZA E PLANEVE TEKNIKO-FINANCIARË**

Në pasqyrat e mëposhtëmë do të jepen të dhëna tekniko-financiare për të gjithë aktivitetet periodikë që zhvillohen në bashki nga familjet rezidente të saj

*Shënim: Në Bashkinë Tepelenë hasim vështirësi në përcaktimin dhe miratimin e parcelave për dru zjarri për fshatarësinë, pasi me ligjin 57/2020 Për pyjet, duhet të ketë Plane Mbarështimi, për pyjet dhe kullotat për cdo Ekonomi Pyjore apo Kullosore. Në Bashkinë Tepelenë kemi vetëm një ekonomi Pyjore (Kurvelesh), në proces hartimi dhe të gjitha të tjerat (E.P/K Sinanaj, E.K Kurvelesh, E.P/K Dukaj-Luzat, E.P.Dragot, E.K. Qëndër), nuk kanë Plane Mbarështimi, të dhënat bazohen në inventaret e vjetra të pyjeve dhe kullotave, në rivlerësimet sporadike, drurëve të thatë, dhe kostatimet e drurëve të dëmtuar nga shkaqe natyrore, të energjencës etj. Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk mund të miratohet mundësia e vjeljes të druve të zjarrit pa plane mbarështimi në fuqi.*

Pyjet përreth Fshatrave Mezhgoran e Peshtan në Nj.A. Qëndër, shtrihen në Zonë të Mbrojtur, dhe nuk mund ti planifikojmë për furnizim me dru zjarri nga pyjet pronë e bashkisë.

Të dhënat do të shërbejnë për të analizuar periodikisht çdo vit rezultatet e arritur në drejtim të ndërhyrjeve për efekt mirëmbajtjeje dhe përmirësimi të terreneve pyjorë/kullosorë që gjenden brenda kufijve të territorialë të çdo fshati, për të analizuar shpenzimet e kryera dhe të ardhurat e përfituara (të shprehura në lekë) sipas çmimeve të tregjeve për periudhën që analizohet. Në pasqyrat ku jepen aftësitë prodhuese të burimeve natyrore në pyje/kullota do të përcaktohen mundësitë vjetore të shfrytëzimeve drusore/foragjere ose të vjeljeve të asortimenteve të tjerë (BMET, prodhime të dyta pyjore) brenda kapaciteteve të riciklueshmëm të terreneve pyjorë/kullosorë që gjenden në kufijtë territorialë sipas fshatrave të bashkisë.

Në këtë kuadër do të jepen edhe të ardhurat neto që përfiton NjQV-ja nga grumbullimi i tarifave të shfrytëzimeve ose përdorimeve të sipërfaqeve pyjore/kullosore, tarifa të cilat do të caktohen sipas ligjit dhe rregullores në fuqi dhe do të përdoren për ri-investime periodike në terrenet pyjorë/kullosorë të çdo fshati.

**1a PLANI VJETOR I SHFRYTËZIMIT TË LËNDËS DRUSORE QË DO TË PARAQITET NË ANKANDIN E SEZONIT '2025-2026**

(bazuar në mundësinë vjetore të shfrytëzimit që jepet në PMPK ose regjistrin kadastral të përditësuar)

Ekonomia pyjore	Fshati	Nr. n/ngastrës	Sip. e përgjith. (ha)	Sip. që do të shfrytëz. (ha)	periudha e shfrytëz.	Llojet drusore që do të priten	Vëllimi i lëndës drusore në këmbë sipas list-damkës				Vlefësi i lëndës drusore në të çelë ankandin		
							e hollë	e mesme + e trashë	Totali	Dru zjarri	lëndë punimi total	dru zjarri	vlefësi si ngastër
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
<b>Totali</b>													



Kurvelesh	Progonat																			
	Gusmar																			
	Rexhin																			
	Nivice																			
	Qyteti																			
	Tepelene																			

Tarifat vendosen sipas VKM nr 559 dt 29.07.2022 "Për përcaktimin e cmimimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim, përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore e jo drusore pyjore".

**Tabela 2a PLANI TEKNIKO-FINANCIAR PËR RI-INVESTIMET NË TERRENET PYJORË**

-Për sezonin 2025-2026

Nr. Rendor	Ekonomia Pyjore	Fshati	Nr. i n/gastres	Sipër. totale (ha)	Sip. që do shfryt zohet (ha)	Faza ose mënyra e prerjes	Lloji drusor	Shfrytëzim/prodh. forazhi			Tarifa Gjithsej në Lekë			
								Lëndë (m <sup>3</sup> )	Dru Zjarrt (m <sup>3</sup> )	Gjethë (Kv)	Nga Lënda (L)	Nga Drutë e Zjarrt (Lekë)	Nga Prodhimi forazhit gjethor (Lekë)	Gjithsej (Lekë)
0	1		3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
1	Dragot	Dragot												
2	Dragot	Becisht												
3	Dragot	Peshtan												
4	Dragot	Mezhgoran				Prerje rigjeneruese/shendetesi mi								
5	Dragot	Koder												
6	Dragot	Lekel												
7	Dragot	Hormove												
8	Dukaj-	Luzat				Prerje								

9	Dukaj-Luzat	Bence	ri gjeneruese/shendetesi mi
10	Dukaj-Luzat	Veliqot	
11	Dukaj-Luzat	Dukaj	
12	Dukaj-Luzat	Turan	
13	Dukaj-Luzat	Mamaj	
14	Dukaj-Luzat	Salari	
15	Sinanaj	Lab Martalloz	
16	Sinanaj	Dhemblan	
17	Sinanaj	Sinanaj	
18	Sinanaj	Matohasanaj	
19	Sinanaj	Dorez	
20	Kurveles h	Lekdush	
21	Kurveles h	Progonat	
22	Kurveles h	Gusmar	
23	Kurveles h	Rexhin	
24	Kurveles h	Nivice	
25	Dukaj-Luzat	Qyteti Tepelene	8,9,10

Prejje ri gjeneruese/shendetesi mi

Hartim Plan Menaxhimi per Pyjet dhe Kullotat

**Tabela 2b. PLANI TEKNIKO-FINANCIAR PËR RI-INVESTIMET NË KULLOTAT BASHKIAKE**

- Për sezonin 2025

Nr/Rendor	Nj.A.	Ngastira Nr.	Nr. pronës në invent.	Pastrim gurësh		Pastrim bimësh të dëmshme		Ndërtim lere		Riparim lere		Ndërtim depozite uji me korite		Sisteme malore	
				Sip. ha	lek e V1.000	Sip. ha	lek e V1.000	copë	V1.000 lekë	copë	V1.000 lekë	Sasia ml	V1.000 lekë	Volum m <sup>3</sup>	V1. lekë
0	1	3	4	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1	Qender									2					
2	Lopes									1					
3	Gusmar									1					

Tab. 3 VLERËSIMI I KAPACITETEVE TË BURIMEVE NATYRORE ME BIMË MJEKSORE, ETEROVAJORE E TANIFERE

Nr. Rendor	Emërtimi i prodhimeve	Njësia e matjes	Pjesa që grumbullohet							Totali Lekë (sipas tarifave)	
			herba e shkoqur	gjethet	lulet ose majat lulore	farat	frutat	rrënjët	lëvoret		
1	Dëllinjë (e kuqe, e zezë)	Kv									
2	Çaj mali	Kv									
3	Trëndafil i egër	Kv									
4	Zhumbricë	kv									
5	Muriz	kv									
6	Shëngjin	Kv									
7	Mollë e egër	Kv									
8	Kulumbri	Kv									
9	Kamomil	Kv									
10	Netull	Kv									
11	Sherebel	Kv									
12	Mëllagë	Kv									
13	Vjezhdull	Kv									
14	Tërfil i kuq	Kv									
15	Bar blete	Kv									
16	Rigon	Kv									
17	Trumëz	Kv									
18	Aguliçe	Kv									
19	Bli	Kv									
20	Frashër i zi	Kv									
21	Shtog	Kv									
<b>TOTALI</b>		<b>KV</b>									

**Tab. 4 VLERËSIMI I KAPACITETEVE TË PRODHIMEVE TË DYTA PYJORE DHE PRODHIMEVE GJEOLGJIKE**

Nr.Rendor	Emërtimi i prodhimeve	Njësia e matjes	Sasia	Çmimi njësi në lekë	Totali Lekë (sipas tarifave)
<b>I.</b>	<b>Prodhime të dyta pyjore</b>				
1	Kërpudha	kv			
2	Gjethë dushku	kv	250	40	10000
3	Forazh barishtor	kv			
4	Fruta pylli, BMET	kv	60	400	24000
5	Humus	kv			
<b>II.</b>	<b>Prodhime gjeologjike</b>				
1	Prodhim inertesh (çakull, granil, gëlqere, argjilë, gurë shtresorë)	m <sup>3</sup>			
2	Prodhim minierar	m <sup>3</sup>			
3	Ujë i pijshëm	m <sup>3</sup> /vit			
4	Ujë termal	m <sup>3</sup> /vit			
<b>Totali në 000/lekë (I+II)</b>					

Shënim: Për të gjithë prodhimet e parashikuar në tabelat 3 dhe 4 do të shënohen sasi të e prodhuara brënda kapaciteteve të riciklueshëm për një sezon dhe llogaritë e të ardhurave komunale do të bëhen sipas tarifave të miratuara institucionalisht.

**Tabela 5 BILANCI i të ardhurave me shpenzimet për një cikël vjetor**

Viti\_2025

Nr.	Të ardhurat e përgjithshme nga vjeljet e tarifave për:	000/Lekë	Nr.	Shperndarja e Fondit te ri-investimeve:	000/Lekë
1	lëndë punimi	0	1	Aktivite investuese ne pyje.	1.000
2	dru zjarri	1.500	a	Pyllezime	0
3	grumbullim forazhi nga gjethe dushku	10	b	Permiresime pyjore	0
4	kullotje ekstensive në fondin kullosor	2.500	2	Aktivite investuese ne kullota.	0
5	kullotje ekstensive në fondin pyjor	100	a	Ndertim/riparim korita	10
6	vjeljet e BMET	280	b	Riparim lere	2.500
7	prodhime të dyta pyjore	60	c	Permiesim/pastrim kullote	0
8	Prodhime materialesh inerte	180	3	Hartim Plani Mbareshtimi ne Pyje e Kullota	1.500
9	Dhënie hapsirash pyjore/kiullosore me qera (kampingje, antena telefonike, kerkimstudim,radiostacione etj.)	1.000		Totali	4.510
Total		5.630			

**Burimet e financimeve për investimet e planifikuara:**

Burimet e financimeve të nevojshëm për të realizuar investimet e planifikuara në pyje/kullota do të jenë si më poshtë:

-Nga fondi i ri-investimeve te bashkisë 3.000. 000 Lekë (Sipas planit afatmesëm miratuar me VKB nr. 72 dt 27.11.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025”.

-Nga donatorë të ndryshëm ,që kanë shprehur interes

IV. KALENDARI I KRYERJES SE AKTIVITETEVE TË PLANIFIKUAR

Nr.Rend.	Nj.A	Aktivitetet e planifikuar	Njësia e matjes	Sasia	Janar	Shkurt	Mars	Pill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
1	Qender	Pyllezim	Ha														
		Permiresim pyje	Ha														
		Permiresim kullote	Ha														
		Riparim Lere	cope														
2	Lopes	Permiresim kullote	Ha														
		Riparim Lere	cope														
		Ndertim/riparim korite	cope														
3	Gusmar	Hartim Pln Mbareshtimi Pyje dhe Kullota	Ha														
		Permiresim kullote	Ha														
		Riparim Lere	cope														
		Ndertim/riparim korite	cope														